| | | | | **3. Sa eshte numri i punonjesve ne ministrine e mbrojtjes qe jane trajnuar per te lexuar te dhenat e sateliteve albania 1 dhe albania 2 dhe sa ka kushtuar trajnimi i tyre?**<br><br>Është plotësuar lista e përbërë nga 22 persona si pika kontakti të 16 institucioneve përfituese nga projekti. Janë kryer takime me të gjithë pikat e kontaktit të institucioneve për ti njohur me ecurinë e projektit si dhe me qëllim rritjen e kapaciteteve teknike të strukturave të cilat janë të përfshira në projekt. Gjatë vitit 2024 kemi kryer trajnime të vëçanta me 38 institucionet publike ku 11 janë institucione qëndrore të interesuara si dhe 27 njësi të qeverisjes vendore (bashki) me pjesmarrjejen e 212 specialistëve.<br><br>Me instuticione qëndrore që kanë shprehur interes për produktet e shërbimit satelitor, janë zhvilluar disa trajnime me specialistë nga:<br><br>• Agjencia kombëtare ujësjellës kanalizimeve.<br>• Përfaqësues nga agjencia kombëtare e zonave të mbrojtura (akzm), | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Agjencia kombëtare e mjedisit (akm),<br>• Agjencia kombëtare e pyjeve (akp)<br>• Agjencia kombëtare e bregdetit (akb).<br>• Autoriteti rrugor shqiptar;<br>• Agjencia kombëtare e burimeve natyrore;<br>• Autoriteti portual durrës;<br>• Korporata elektroenergjitike shqiptare.<br>• Hekurudha shqipëtare.<br>• Ikmt (inspektoriati kombëtar i mbrojtjes së territorit).<br><br>**4. Ju lutem na vendosni ne dispozicion kur ka nisur ky trajnim dhe kur ka perfunduar.**<br><br>Trajnimet kanë filluar që në dhjetor të 2023 dhe vazhdojnë në mënyrë periodike gjatë gjithë kohës<br>Së zbatimit të këtije projekti me të gjithë institucionet përfituese. | | |
| 11 | 11.07.2024 | Përshëndetje,<br><br>Uroj të jeni mirë! Jam sokol dema, gazetar i kronikës në report tv.<br><br>Në kuadër të interesit publik për informim dhe të drejtës së informimit në bazë të ligjit nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, jam i interesuar për disa të dhëna në lidhje me përdorimin e helikopterëve të ministrisë së mbrojtjes | 15.07.2024 | Përshëndetje,<br><br>Më poshtë do të gjeni përgjigjet për pyetjet tuaja, që kanë të bëjnë me akmc-në. | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për situatat emergjente. Më poshtë keni të renditura disa pyetje, për të cilët media jonë është e interesuar.<br><br>-sa helikopterë ka në përdorim aktualisht ministria e mbrojtjes?<br>-a janë të gjithë në gjendje pune?<br>-sa prej tyre përdoren për emergjenca për shuarjen e zjarreve?<br>-një helikopter shihet të jetë në ndihmë të policisë së shtetit në kontrollet për kanabis. Është i njëjti që ndihmon në shuarje e zjarreve apo tjetër?<br>-çfarë kapacitetesh ka akmc për përballimin në veçanti të situatave të zjarreve?<br><br>Duke iu falënderuar për mirëkuptimin,<br><br>Sokoli | | 1. Sa prej tyre përdoren për emergjenca për shuarjen e zjarreve?<br><br>Për kryerjen e operacioneve të ndryshme të emergjencave civile, janë në dispozicion 2(dy) helikopterë.<br><br>2. Çfarë kapacitetesh ka akmc për përballimin në veçanti të situatave të zjarreve?<br>Bazuar në nenin 23 ,pika 3 e ligjit 45/2019 ’’për mbrojtjen civile’’ agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.<br>Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, janë:<br>a) forcat e armatosura;<br>b) policia e shtetit;<br>c) shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit;<br>Ç) shërbimi i urgjencës mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;<br>D) shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.<br>Gjithashtu, gjatë situatës së zjarreve në bashkinë dropull dhe delvinë është aktivizuar edhe mekanizmi europian i mbrojtjes civile, të cilët, kanë mbështetur me avionë pzl dhe canadair. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Punë të mbarë! | | |
| 12 | 28.07.2024 | Përshëndetje jam rrezon gashi gazetar në ktv. Po ju shkruaj lidhur me komunikatën e shërbimit të kërkim shpëtimit malor të kosovës në të cilën thanë se autoritetet shqiptare nuk ua ofruan ndihmën me helikopter për të nxjerrë trupin e pajetë.<br>Pse ka ndodhur kjo?<br><br>Me respekt,<br>Rrezon gashi<br>Gazetar në kohavision<br>+38344842452 | 01.08.2024 | Pershendetje,<br><br>Qendra kombetare operacionale e emergjencave civile (qkoec) eshte njoftuar nga policia e shtetit dhe strukturat e emergjencave civile te bashkise tropoje qe nje nga alpinistet, shtetas kosovar ka rene ne gremine ne vendin e quajtur "maja e thate" dhe si pasoje ka humbur jeten.<br><br>Efektivet e policise se shtetit bashke me ekipin e kerkim-shpetimit nga kosova kane bere te mundur nxjerrjen e tre prej turisteve, por ishte e pamundur nderhyrja nga toka per nxjerrjen e trupit te pajete.<br><br>Per shkak te terrenit te thepisur malor policia e shtetit iu drejtua qkoec-se  per mbeshtetje me helikopter per nderhyrje nga ajri, pas komunikimit me ministrine e mbrojtjes nese helikopteri ishte ne gatishmeri, jemi njoftuar qe helikopteri cougar qe sherben per nderhyrje ne shuarjen e zjarreve dhe rastet e kerkim- shpetimit nuk ishte ne gjendje gatishmerie pasi kishte plotesuar oret e fluturimit ne oepracionet e shuarjes se zjarreve.<br><br>Menjehere eshte ne dijeni policia e shtetit dhe strukturat e | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | emergjencave te bashkise tropoje, te cilet ne vijim kane koordinuar operacionin per nxjerrjen e trupit nga vendi i quajtur "maja e thate".<br><br>Ju faleminderit dhe pune te mbare! | | |
| 13 | 30.07.2024 | Bazuar në ligjin nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, po u dërgoj pyetjet e mia më poshtë<br><br>Bashkitë korçë, pogradec , maliq dhe devoll kanë depozituar prane emergjencave civile disa kërkesa per demshperblim te fermerëve si pasoje e dëmeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore, perse emergjencat nuk i kane levruar fondet?<br><br>- sa kerkesa iu kane ardhur nga i gjithe vendi per dëmshpërblim të fermereve? | 06.08.2024 | Ërshëndetje,<br>Referuar kërkesës tuaj për informacion -ju sqarojmë sqarojmë se:<br><br>Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, bazuar vkm-së nr. 329, datë 16.05.2012, “për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, nuk disponon asnjë dokumentacion të përcjellë nga bashkitë korçë, devoll, pogradec dhe maliq me qëllim dëmshpërblimin e fermerëve si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.<br><br>Gjithashtu ju informojmë se, bazuar vkm-së së sipërcituar kompensimi financiar i fermerëve për dëme në kulturat bujqësore dhe blegtorale ndodh në rastet kur është shpallur gjendja e emergjencave civile.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | 12.08.2024 | Nisur nga situata kritike e krijuar ne parkun kombetar te prespes do t'ju lutesha te me vinit ne dispozicion informacionin si me poshte:<br><br>- Autoritetet vendore kane bere thirrje per nderhryje te menjehershme nga ajri, a eshte ne planet e qendres kombëtare operacionale te emergjencave civile nderhyrja nga ajri?<br><br>- Nese po, kur pritet te nderhyhet?<br><br>- Si behet vleresimi per nderhyrjet nga ajri? | 13.08.2024 | Më datë 05.08.2024, ora 11:00, kemi marr njoftim nga prefektura korçë se në pikën kufitare goricë e madhe, në malin e thatë, bashkia pustec, ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe kullotë. Në vendngjarje menjëherë janë angazhuar shërbimi vendor i mzsh të bashkisë pustec, forca policore, forca nga administrata e zonave të mbrojtura, forca bashkiake, shërbimi pyjor, të cilët punuan për izolimin e vatrës së zjarrit. Në ditët në vijim për fikjen e zjarrit, në operacion janë angazhuar në mbështetje të strukturave lokale efektiv të forcave të armatosura. Në datën 07.08.2024 bazuar në kërkesën e prefekturës korçë për mbështetje nga ajri, u realizua ndërhyrja nga ajri nëpërmjet helikopterit cougar të forcave të armatosura. Sipas raportimeve të prefekturës korçë, gjatë këtyre ditëve vatra e zjarrit ka qenë e izoluar, por në datën 12.08.2024 si pasojë e erërave të forta kemi pasur riaktivizim të vatrës së zjarrit, ku kryesisht digjet sipërfaqe me bar, dëllinja dhe pjesërisht pyll dushku i shkurtër dhe ahu. Gjatë këtyre ditëve kemi pasur angazhim në nivel lokal edhe qendror. Në shuarjen e kësaj vatre zjarri në total janë angazhuar 195 forca në nivel lokal, 4 mjete zjarrefikëse, 107 efektiv nga forcat e armatosura dhe helikopteri cougar. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe vendi ynë është përballur me disa vatra zjarri, të cilat kanë rrrezikuar zonat e | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | banuara në bashkitë shëngjin, finiq, delvinë, rrogozhinë, kavajë, dropull, tepelenë dhe gjirokastër. Vlerësimin për ndërhyrjen nga ajri bëhet bazuar nivelit të riskut që një vatër zjarri paraqet, ku prioritet kanë zonat e banuara, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashgimisë kulturore dhe të mjedisit. Nisur nga situata e zjarreve në vend agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, i është drejtuar për ndihmë mekanizmit europian të mbrojtjes civile, i cili i është përgjigjur menjëherë dhe është ofruar për ndihmë rumania. Gjatë ditës së nesërme, më datë 14.08.2024, do të dislokohet ekipi rumun, i cili do të operojë me mjetin ajror c-27j (spartan), në zonën e parkut kombëtar të prespës, në mbështetje të strukturave operacionale të vendit tonë, të cilat vijojnë të operojnë nga toka. | | |
| 15 | 18.09.2024 | Nisur nga premtimi i ish ministrit të mbrojtjes niko peleshi, datë 8 janar 2023, mbi shtimin e flotës ajrore me dy avionë për shuarjen e zjarreve do t'ju lutesha të më vinit në dispozicion informacionet si më poshtë: · a janë nisur procedurat për blerjen e dy avionëve? · nëse po, sa është planifikuar fondi për këtë blerje? · nëse jo, listoni arsyet e vonesave · kur pritet të vihen në punë avionët -si pjesë e flotës ajrore për shuarjen e zjarreve? · ju lutem të na vini në dispozicion litën e investimeve që janë planifikuar si investime nga huaja 30 milionë euro nga italia, si "mbështetje për ngritjen e sistemit të mbrojtjes civile në shqipëri" | 23.09.2024 | **Projekti "mbështetje për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes civile në shqipëri", kredi 30 milion euro nga qeveria italiane**<br><br>Buxheti – 30 milion euro, kredi e qeverise italiane<br><br>Kohëzgjatja e diskutimeve: ideja për këtë projekt ka filluar pas konferencës së donatoreve të mbajtur pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Diskutimet kanë nisur në vitin 2020 si dhe shkrimi i projektit | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në bashkëpunim midis akmc, aics dhe mzsh ka përfunduar në vitin 2021.<br><br><u>Koha e nevojshme e përllogaritur për implementimin e tij</u> – afati i implementit të projektit është 2 vjet nga momenti i fillimit/aktivizimit të tij.<br><br>**<u>Qëllimi i këtij projekti:</u>**<br><br>Është reduktimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile si dhe reduktimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga: zjarret në pyje, përmbytjet, tërmetet etj., në shqipëri nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile shqiptare duke investuar në:<br><br>**1.** Ndërtimi i një godine katërkatëshe për selinë e akmc dhe qendrën kombëtare operacionale të emergjencave civile si dhe katër (4) qendrat rajonale të mbrojtjes civile të ngritura (shkodër, korçë, fier dhe durrës), të cilat të gjitha do të pajisen plotësisht me mjete të rënda operacionale, 2 avionë zjarrfikës dhe sistemet moderne të monitorimit dhe koordinimit të teknologjisë së informacionit;<br>**2.** Blerjen e pajisjeve për sistemet e monitorimit dhe koordinimit të teknoligjisë së informacionit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | për 12 prefekturat e vendit (në nivel rajonal);<br>**3.** Blerjen e mjeteve operative për stacionet zjarrfikëse, pajisje për kërkim shpëtim (sar) dhe pajisje mbrojtëse personale për forcat zjarrëfikëse për 61 bashki që mbulojnë të gjithë territorin e shqipërisë;<br>**4.** Ndërtimi i një kampi trajnimi për mbrojtjen civile për forcat operacioanle.<br><br>- **Është realizuar deri më tani:**<br>**1.** Është hartuar forma e identifikimit të projektit (pif);<br>2. Është bërë vlerësimi i relevancës së projektit (sra);<br>3. Ky projekt është miratuar në komitetin e planifikimit strategjik (kps) në saspac nga ministri i mbrojtjes dhe është përfshirë në listën unike kombëtare të projekteve, në zbatim të nenit 3 të vkm nr. 185, datë 29.3.2018, “për menaxhimin e investimeve publike në republikën e shqipërisë”.<br>4. Nëpërmjet vkm me nr. 829, datë 19.12.2022, “për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërqeveritare, ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së shqipërisë dhe qeverisë së republikës italiane, përfaqësuar nga ministria e punëve të jashtme dhe | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bashkëpunimit ndërkombëtar, në lidhje me një hua koncesionare “për mbështetje për ngritjen e sistemit të mbrojtjes civile në shqipëri””, është bërë miratimi në parim i këtij projekti si dhe është bërë vlerësimi i relevancës strategjike të projektit.<br>5. Ky projekt është dakordësuar me aics dhe drejtorinë e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në ministrinë e brendshme me shkresën nr. 773 prot., datë 23.1.2023.<br><br>**Faza aktuale:**<br><br>Pritet përfundimi i procedurave të brendshme në qeverinë e italisë dhe më pas ratifikimi i marrëveshjes në parlamentin shqiptar.<br><br>**Ministria lider në sektor:**<br><br>- (ministria lider që është përgjegjëse kryesore lidhur me projektin: ministria e mbrojtjes e republikës së shqipërisë<br><br>**Departamenti i nën-sektorit:**<br><br>- Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile<br><br>**Projekti eshtë në përputhje/koherencë me:**<br><br>- Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015 - | | |

2020 (që është ende në fuqi), kapitulli 8, paragrafi 8.5 “objektiva strategjikë në lidhje me reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e mbrojtjes civile”.

- Strategjinë kombëtare të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë 2023-2030, të miratuar me miratuar me vendim te keshillit te ministrave nr. 94, date 22.03.2023, si dhe me strategji të tjera që lidhen me cështjet e mjedisit dhe ndryshimet klimatike.

**Tabelë përmbledhëse e projektit**:

| **Komponentët e projektit** | | | |
|---|---|---|---|
| Ndërtimi i godinës duke përfshirë planifikimin, dizajn teknik dhe supervizim për selinë qendrore të akmc | | | |
| Ndërtimi dhe pajisja e 4 qendrave rajonale të mbrojtjes civile | | | |
| Pajisje monitorimi dhe it për 12 prefekturat | | | |
| **Total 1** | | | |
| Mjete të rënda dhe special si dhe 2 avionë zjarrfikës për 4 qendrat rajonale të mbrojtjes civile | | | |
| Pajisje për stacionet zjarrfikëse dhe mjete për fikjen e zjarreve si dhe pajisje personale për 61 bashkitë e vendit | | | |
| **Total 2** | | | |
| Ndërtimi i një kampi trajnimi për stafin operacional të mbrojtjes civile | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Total 3** | | |
| | | | | **Total (1+2+3)** | | |
| 16 | 30.09.2024 | Tiranë më 30/09/2024<br><br>Kërkesë për informacion<br><br>Nga: top channel, emisioni "fiks fare", tiranë<br><br>Drejtuar: ministrisë së mbrojtjes, agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile<br><br>Lënda: kërkesë për informacion<br><br>Për t'i ardhur në ndihmë informacionit të saktë publik, në bazë të ligjit nr.119/2014 neni 15 pika 1 dhe 2 (për të drejtën e informimit) dhe kushtetutës, redaksia e emisionit "fiks fare" në televizionin "top channel", kërkon nga ministria e mbrojtjes, agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, intervistë, informacion ose dokumente për situatën e zjarreve gjatë verës 2024.<br><br>1. A ka evidenca agjencia kombëtare e mbrojtjes civile për situatën e zjarreve? Nëse po, a mund të na vini në dispozicion sa vatra zjarri kanë rënë në të gjithë shqipërinë në periudhën 1 qershor 2024 – 30 shtator 2024? Sa sipërfaqe pyje janë djegur, sa kullota, sa shtëpi, biznese etj?<br><br>2. A ka mjet ajror në punë shteti shqiptar, ministria e mbrojtjes, akmc për të luftuar nga ajri rënien e zjarreve? Sa operacione për shuarjen e zjarreve janë bërë nga ajri në periudhën 1 qershor – 3- shtator 2024? | 10.01.2024 | Tiranë më 30/09/2024<br><br>Kërkesë për informacion<br><br>Nga: top channel, emisioni "fiks fare", tiranë<br><br>Drejtuar: ministrisë së mbrojtjes, agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile<br><br>Lënda: kërkesë për informacion<br><br>Për t'i ardhur në ndihmë informacionit të saktë publik, në bazë të ligjit nr.119/2014 neni 15 pika 1 dhe 2 (për të drejtën e informimit) dhe kushtetutës, redaksia e emisionit "fiks fare" në televizionin "top channel", kërkon nga ministria e mbrojtjes, agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, intervistë, informacion ose dokumente për situatën e zjarreve gjatë verës 2024.<br><br>1. A ka evidenca agjencia kombëtare e mbrojtjes civile për situatën e zjarreve? Nëse po, a mund të na vini në dispozicion sa vatra zjarri kanë rënë në të gjithë shqipërinë në periudhën 1 qershor | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Sa helikopterë, mjete ajrore, ka baza ajrore në farkë? Sa janë në gjendje pune dhe sa janë në remont? Sa prej tyre përdoren për të luftuar zjarret? A kanë qenë në gjendje pune këta helikopterë për zjarret në këtë periudhë ?<br><br>4. Sa mjete zjarrfikëse ka në pronësi akmc, çfarë viti prodhimi janë dhe a kanë qenë në gjendje pune gjatë periudhës 1 qershor – 30 shtator 2024?<br><br>Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj<br><br>Me respekt,<br><br>Gazetari i emisionit fiks fare<br><br>Sokol çobo | | 2024 – 30 shtator 2024? Sa sipërfaqe pyje janë djegur, sa kullota, sa shtëpi, biznese etj?<br><br>· sipas të dhënave të raportuara pranë qendrës kombëtare operacionale të emergjencave civile nga institucionet e prefekturave në periudhën 1 qershor 2024 deri 15 shtator 2024, vatrat e zjarrit janë si më poshtë:<br><br>· sipas raportimeve të bëra nga strukturat e pushtetit vendor, si dhe të dhënat e marra nga sistemi evropian i informimit të zjarreve në pyje (effis) dëmet e shkaktuara nga zjarret gjatë sezonit veror janë si më poshtë.<br><br>· pavarësisht numrit të madh të zjarreve por edhe sipërfaqes së konsiderueshme të djegur, dëmet e shkaktuara, sipas llojit të bimësisë së djegur janë si më poshtë:<br><br>2. A ka mjet ajror në punë shteti shqiptar, ministria e mbrojtjes, akmc për të luftuar nga ajri rënien e zjarreve? Sa operacione për shuarjen e zjarreve janë bërë nga ajri në periudhën 1 qershor – 3- shtator 2024?<br><br>· për shuarjen e zjarreve në periudhën 1 qershor deri 15 shtator 2024 janë angazhuar 2 helikopterë cougar, të cilët kanë kryer 36 operacione nga ajri. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 3. Sa helikopterë, mjete ajrore, ka baza ajrore në farkë? Sa janë në gjendje pune dhe sa janë në remont? Sa prej tyre përdoren për të luftuar zjarret? A kanë qenë në gjendje pune këta helikopterë për zjarret në këtë periudhë ?<br><br>4. Sa mjete zjarrfikëse ka në pronësi akmc, çfarë viti prodhimi janë dhe a kanë qenë në gjendje pune gjatë periudhës 1 qershor – 30 shtator 2024?<br><br>· bazuar në ligjin nr. 45, datë 18.7.2019 “për mbrojtjen civile”, agjencia kombëtare e mbrojtjes civile ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.<br><br>Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile nuk ka mjete zjarrfikëse në pronësi të saj. Bazuar në ligjin nr. 45, datë 18.7.2019 “për mbrojtjen civile”, neni 32, strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, janë:<br><br>A)forcat e armatosura;<br><br>B)policia e shtetit;<br><br>C)shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ç)shërbimi i urgjencës mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;<br><br>D) shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile. | | |
| 17 | 15.10.2024 | Ju lutem, kërkojmë të na vini në dispozicion informacion në lidhje me këto pyetje:<br><br>1.sa ishte niveli i reshjeve në vlorë në datën 4 tetor 2024?<br><br>2. Sa është mesatarja e reshjeve në 5 vitet e fundit në vlorë? (konkretisht 2020; 2021; 2022;<br><br>2023;2024)<br><br>3. Në cilat vite janë regjistruar sasitë më të mëdha të reshjeve në vlorë? (ju lutem, specifikoni) | 17.10.2024 | Përshëndetje znj. Hoxha,<br><br>Ju falënderojmë për pyetjet e dërguara. Megjithatë, dëshirojmë t'ju informojmë se pyetjet tuaja nuk janë në fushën e përgjegjësisë së agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile (akmc).<br><br>Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile (akmc) është person juridik publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e republikës së shqipërisë.<br>Akmc ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.<br><br>Për informacionin e kërkuar mbi reshjet dhe të dhënat meteorologjike, ju sugjerojmë të kontaktoni institutin e gjeoshkencave (igjeo), i cili është institucioni i duhur për t'ju asistuar me këto çështje. | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe mbetemi në dispozicion për çdo çështje tjetër që lidhet me fushën tonë të përgjegjësisë. | | |
| 18 | 29.10.2024 | Pyetjet për kreun e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, haki çako, mbi projektet nga njësitë vendore në kuadër të mbrojtjes civile:<br><br>1. Cilat janë prioritetet kryesore të projekteve të mbrojtjes civile në nivel vendor, në kuadër edhe të thirrjes ndaj njësive të qeverisjes vendore, për projektin e infrastrukturës parandaluese për mbrojtjen civile?<br>2. Sa është fondi që është parashikuar të alokohet nga qeverisja qendrore për projektet që do paraqiten nga thirrja e hapur së fundmi për çështje të emergjencës civile?<br>3. Si po ndihmojnë këto projekte në përmirësimin e kapaciteteve të njësive vendore për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore?<br>4. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen njësitë vendore gjatë zbatimit të projekteve për mbrojtjen civile?<br>5. Çfarë roli ka agjencia kombëtare e mbrojtjes civile në koordinimin dhe mbështetjen e këtyre projekteve?<br>6. Si po bashkëpunojnë njësitë vendore me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me mbrojtjen civile?<br>7. Çfarë lloj mbështetje financiare dhe logjistike ofrohet nga agjencia për njësitë vendore?<br>8. Si po përgatiten njësitë vendore për t'iu përgjigjur emergjencave të ndryshme si përmbytjet, zjarret, dhe tërmetet?<br>9. A ka programe trajnimi specifike që ndihmojnë stafin vendor në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave? | 01.11.2024 | 1. Cilat janë prioritetet kryesore të projekteve të mbrojtjes civile në nivel vendor, në kuadër edhe të thirrjes ndaj njësive të qeverisjes vendore, për projektin e infrastrukturës parandaluese për mbrojtjen civile?<br><br>Prioriteti kryesor është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile, duke përfshirë infrastrukturën parandaluese dhe forcimin e reagimit të njësive vendore përballë emergjencave.<br><br>2. Sa është fondi që është parashikuar të alokohet nga qeverisja qendrore për projektet që do paraqiten nga thirrja e hapur së fundmi për çështje të emergjencës civile?<br><br>Fondi do të përcaktohet nga ministria e financës, duke u bazuar në vlerësimet financiare të nevojshme për mbështetjen e projekteve të propozuara nga njësitë vendore.<br><br>3. Si po ndihmojnë këto projekte në përmirësimin e kapaciteteve të | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 10. Si po përdoren teknologjitë dhe inovacionet e reja në projekte për përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave në nivel lokal?<br>11. Cilat janë projektet më të rëndësishme që janë realizuar deri më tani në kuadër të mbrojtjes civile dhe çfarë impakti kanë pasur? | | njësive vendore për t'u përballur me fatkeqësitë natyrore?<br><br>Projektet kanë një rol kyç në forcimin e kapaciteteve parandaluese dhe përmirësimin e përgjigjes ndaj fatkeqësive, duke siguruar mjete dhe infrastruktura të përshtatshme për përballjen me situata emergjente.<br><br>4. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen njësitë vendore gjatë zbatimit të projekteve për mbrojtjen civile?<br><br>Njësitë vendore përballen me sfida të shumta, përfshirë mungesën e fondeve të qëndrueshme, kapacitete të kufizuara teknike dhe logjistike, si dhe nevojën për trajnime të vazhdueshme për stafin.<br><br>5. Çfarë roli ka agjencia kombëtare e mbrojtjes civile në koordinimin dhe mbështetjen e këtyre projekteve?<br><br>Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile ka rol koordinues, drejtues dhe mbikëqyrës në të gjitha fazat e zhvillimit të projekteve, duke ofruar udhëzime teknike dhe duke administruar mbështetjen financiare për zbatimin efektiv të tyre, sipas përcaktimeve ligjore. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 6. Si po bashkëpunojnë njësitë vendore me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me mbrojtjen civile?<br><br>Në nivel lokal zhvillohen fushata informuese dhe sensibilizuese, si në ditën ndërkombëtare të zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë më 13 tetor, duke përfshirë qytetarët në aktivitete ndërgjegjësuese.<br><br>7. Çfarë lloj mbështetje financiare dhe logjistike ofrohet nga agjencia për njësitë vendore?<br><br>Agjencia ofron fonde të kushtëzuara dhe mbështetje logjistike për emergjencat civile, për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe rehabilitimin e digave, në përputhje me buxhetet e përcaktuara çdo vit.<br><br>8. Si po përgatiten njësitë vendore për t'iu përgjigjur emergjencave të ndryshme si përmbytjet, zjarret, dhe tërmetet?<br><br>Njësitë vendore po rrisin kapacitetet njerëzore dhe logjistike, duke zhvilluar trajnime dhe investuar në pajisje moderne që ndihmojnë në përballimin efektiv të emergjencave. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 9. A ka programe trajnimi specifike që ndihmojnë stafin vendor në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave?<br><br>Po, zhvillohen trajnime të ndryshme si stërvitja e fundit në tavolinë në dibër për menaxhimin e fatkeqësive gjatë dimrit, e cila forcon aftësitë dhe gatishmërinë e njësive vendore.<br><br>10. Si po përdoren teknologjitë dhe inovacionet e reja në projekte për përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave në nivel lokal?<br><br>Teknologji të reja, si sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit, po përdoren për të përmirësuar reagimin e shpejtë dhe efektiv ndaj situatave emergjente.<br><br>11. Cilat janë projektet më të rëndësishme që janë realizuar deri më tani në kuadër të mbrojtjes civile dhe çfarë impakti kanë pasur?<br><br>Nga viti 2021 deri në 2024 janë realizuar gjithsej 95 projekte me vlerë rreth 3,650,000,000 lekë, të cilat kanë sjellë përmirësime të dukshme në kapacitetet përballuese të njësive vendore dhe përmirësimin e infrastrukturës së mbrojtjes civile. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | 26.11.2024 | Pershendetje, uroj te jeni mire!<br><br>Ju shkruaj  nga "bar restaurant piazza" ne qender.<br><br>Ne pallatin ku ndodhet biznesi jone eshte prishur fasada sipas videos qe eshte bashkangjitur emeilil tone. Ne jemi te shqetesuar per klientet  dhe kalimtaret qe kalojne aty.<br><br>Mund te marren masa per riparime per parandalimin e prishjes se metejshme te fasades?<br><br>Ne qoftese nuk merreni ju direkt me kete problem ku mund te drejtohem?<br><br>Faleminderit!<br><br>Diten e mire | 27.11.2024 | E nderuar,<br>Ju falënderojmë që na informuat mbi situatën shqetësuese të fasadës së pallatit ku ndodhet biznesi juaj. Dëshirojmë t'ju informojmë se çështje të tilla që lidhen me riparime dhe sigurinë e ndërtesave në nivel lokal trajtohen nga sektori përkatës i emergjencave në bashkinë ku ndodheni. Ju këshillojmë që t'i drejtoheni këtij sektori/ drejtorie për të raportuar problemin dhe për të kërkuar ndërhyrje për riparimin e fasadës, duke qenë se ata kanë kompetencën për të menaxhuar dhe zgjidhur këto situata ne nivel vendor.<br>Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile (akmc) merret me menaxhimin dhe koordinimin e fatkeqësive në nivel kombëtar dhe ndërhyrjet që përfshijnë disa nivele administrative. Megjithatë, për këtë rast specifik, bashkia është autoriteti më i përshtatshëm për ndjekjen dhe zgjidhjen e çështjes.<br>Mbetemi në dispozicion për cdo çështje që lidhet me detyrat dhe përgjegjësitë e akmc-së.<br>Me respekt, | E plote | Nuk ka |
| 20 | 11.12.2024 | Kërkesë<br><br>Agjencia kombetare e mbrojtjes civile tirane<br><br>Unë i nënshkruara xxxx po ju bej kete kerkese zyres tuaj qe te ma zgjidhni kete problem qe kam ne lidhje me shtepine time se une jam ne gjendje shume te veshtire ne shtepi sepse eshte ne rrezik per jeten kjo shtepi. | 16.12.2024 | Përshëndetje z. Xxxx<br><br>Referuar rastit tuaj , ju informojmë se:<br>Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile, bazuar ligjit nr. 45/2019 "për mbrojtjen civile", në kuadër të ushtrimit të autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kur ra termeti i madhe gjate vitit 2019 mua mu demtuan muret e shtepise gjate asaj kohe.<br><br>Gjate kesaj kohe kam bere kerkese tek bashkia fushe-arres,puke.sa here dhe nuk me kane zgjidhur problemin e shtepise vetem me kane ofruar vetem disa ndihma ushqimore dhe disa sende per shtepine.<br><br>Une kerkoj nga juve te me ndihmoni te rregulloj shtepine sepse jam kryefamiljar i 8 (tete) antareve te shtepise ne te cilen nga pamundesia per ta rregulluar vete po kerkojme ndihmen nga ana juaj qe ten a perkrahni ne kete problem pasi jeta jone po rrezikohet cdo dite dhe me keq. Une jam 80 vjec , bashkeshorten 78 vjece ndersa antaret e tjere te familjes jan djali 55 vjec me bashkeshoreten 49 vjece dhe femijet e tyre jan 6,4,2 dhe 1 vjec. Tani me date 21.11.2024 filloi nje stuhi e madhe e cila me demtoi pjeset e catise se shtepise, ndersa muret qe ishin te plasaritura qe nga termeti u demtuan me shume. Ne kete kushte qe eshte shtepia eshte e pabanueshme dhe kerkoj nga ana juaj te me ndihmoni ne rikonstruktimin e shtepise sa me shpejt te jete e mundur pasi kjo situate mund te kaloje ne nje tragjeti te familjen time.<br><br>Kerkoj nga ana juaj qe nje grup ekspertesh te fushes se fatkeqesive natyrore te verifikoje , a mund te jetohet ne keto kushte qe ndodhet shtepia ime qe nga ndodhia e fundit qe ishte stuhia e madhe e cila levizi gjithe catine dhe ne jemi munduar te vendosim senet e renda siper catise per shkak se era filloi ta ngrente catine ne ajer.<br><br>Mbetëm në pritje të përgjigjes tuaj.<br><br>Me respekt,<br><br>Kerkoj pergjigjjen ne kete email.<br><br>Email: | | mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, me qëllim parandalimin dhe evitimin e pasojave me rrezik humbjen e jetës së njerëzve, pronat e tyre, mjedisin, si dhe veprimtaritë e tyre ekonomike, ju informon se trajtimi i rastit në fjalë është kompetencë e bashkisë fushë-arrëz.<br>Për sa më sipër, kërkesa juaj do të përcillet për kompetencë bashkisë fushë-arrëz.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin | | |